

**KUVENDI I PILOT NJËSISË KOMUNALE
JUNIK**

S T A T U T I
I PËRKOHSHËM I PILOT NJËSISË KOMUNALE

Junik
Prill, 2006

Në bazë të nenit 11. paragrafi 1. të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, Nr. 45/2000, Urdhëresës Administrative No. 2000/28, Kuvendi i Përkohshëm i Pilot Njesisë Komunale – Junik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 13.04.2006, miratoi këtë:

STATUT

Kapitulli I

Dispozitat e përgjithshme

Pjesa 1

Neni 1.

Pilot Njësia Komunale është njësi territoriale-administrative, në të cilën qytetarët realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me dispozitat e Rregullores nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, Ligjet e aplikueshme, Urdhëresës Administrative 2005/11 dhe me këtë Statut të përkohshëm.

Neni 2

Pilot Njësia Komunale (PNJK) është person juridik.

Neni 3.

Pilot Njësia komunale ka emblemën e vet. Përmbajtja dhe përdorimi i emblemës përcaktohet me vendim të Kuvendit të përkohshëm dhe përfundimisht aprovohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Neni 4.

Pilot Njësia Komunale (PNJK) është bartëse e të drejtës së pronësisë në pronat komunale e të gjitha llojeve (tokës, hapësirës afariste, objekteve të ndryshme, ndërtesave, pyjeve, ujërave, dhe resurseve të tjera) në territorin e Pilot Njesisë të cilat shfrytëzohen dhe administrohen nga komuna në përputhje me Ligjin e aplikueshëm.

Kuvendi i Përkohshëm i Pilot njesisë Komunale me vendim do t'i themelojë ndërmarrjet me interes të posaçëm për komunën, në përputhje me Rregulloren 2002/12 dhe me legjislacionin pasues për këtë çështje.

Neni 5.

Selia e Pilot Njesisë komunale është në Junik.

Neni 6

Pilot Njësia Komunale ka vulën e vetë të rrumbullakët dhe vulën katrore të protokollit. Teksti i vulës është: **Pilot Njësia Komunale Junik (me stemën e Kosovës në mes).**

Neni 7

Vulat janë në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Mbajtja dhe përdorimi i tyre përcaktohet me vendim të Kuvendit të përkohshëm të kësaj pilot njësie Komunale.

Neni 8

Pilot njësia komunale e ka territorin e vet të përcaktuar me Vendimin Ekzekutiv nr. 2005/19 mbi ndarjen territoriale të pilot njësisë komunale të Junikut dhe përfshinë pesë zona kadastrale:

1. Junik (Nr.kad.70505038)
2. Jasiq-Gjocaj (Nr.kad.70505036)
3. Rastavicë (Nr.kad.70505065)
4. Sllup (Nr.kad.70505072)
5. Voksh (Nr.kad.70505011)

Neni 9.

Pilot Njësia Komunale në Junik feston Festat te cilat i përcakton Qeveria e Kosovës, Dita e festës së pilot njësisë Komunale caktohet me vendim të Kuvendit të përkohshëm.

Neni 10.

Pjesëtarëve të komuniteteve dhe bashkësive nacionale u garantohet e drejta e deklarimit të lirë të identitetit etnik, kulturor dhe fetar. Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me organet dhe shërbimet civile në Pilot njësinë Komunale.

Neni 11.

Mbledhjet e Kuvendit të përkohshëm të PNJK-së, komiteteve të tij dhe tubimet tjera do të mbahen në gjuhët: bazuar në nenin 9 të Rregullores 2000/45.

Të gjitha dokumentet zyrtare që lëshohen nga organet dhe shërbimet e PNJK duhet të jenë në dy gjuhë zyrtare. PNJK do të lëshojë dokumente palëve në gjuhën e tyre amtare.

Pjesa 2

Neni 12.

Ky Statut përcakton në veçanti:

- 12.1 Përgjegjësitë dhe funksionet e Kuvendit të përkohshëm të PNJK.
- 12.2. Pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve, aktivitetin dhe mënyrën e vendosjes së punëve në kuadër të kompetencave të PNJK.
- 12.3. Organet e Kuvendit të përkohshëm të PNJK dhe shërbimin civil.
- 12.4. Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Kuvendit të përkohshëm të PNJK;
- 12.5. Administrimin financiar;
- 12.6. Konfliktin e interesave dhe
- 12.7. Dispozitat e veçanta

Kapitulli II

Pjesa 1

Përgjegjësitë dhe kompetencat e PNJK

Neni 13.

PNJK në pajtim me Statutin dhe ligjet e aplikueshme ushtron pushtetin në këto veprimtari:

- 13.1. Miraton programet e zhvillimit të veprimtarive komunale,
- 13.2. Ofrimin e kushteve për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm,
- 13.3. Siguron, organizon dhe rregullon shkollimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- 13.4. Siguron dhe kujdeset për politikat shëndetësore (zhvillon mjekësin familjare), politiken sociale, strehimin dhe mbrojtjen e konsumatorëve e shëndetin publik,

- 13.5. Miraton buxhetin, raportet periodike dhe vjetore të buxhetit, raportet e punës së drejtorive dhe atë të qeverisë lokale (bordit të drejtorëve).
- 13.6. Miraton planin hapësinor, planet urbane dhe shfrytëzimin e tokës në tërë territorin e PNJK të Junikut (rregullore e veçantë),
- 13.7. Rregullon dhe siguron kryerjen e veprimtarive komunale,
- 13.8. Menagjon pronën komunale me asetet e luajtshme dhe të paluajtshme,
- 13.9. Kujdeset dhe ndihmon në bashkëpunim me departamentet përkatëse qendrore, mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare ,shërbimin e emergjencës (zjarrfikësve),
- 13.10. Benë lëshimin e lejeve për shërbime të caktuara publike duke përfshirë: Lojërat argëtuese dhe tjera, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin lokal publik, gjuetinë, lokalet shërbyese si restorante, motele, hotele dhe panaire,
- 13.11. Cakton shkallen e pagesave dhe tarifave për të hyrat publike në nivel lokal (konform rregulloreve lokale dhe atyre qendrore),
- 13.12. Siguron shërbimet publike në nivel lokal duke përfshirë: a) furnizimin me ujë (ujësjellësi dhe kanalizimi) krijimin e kushteve për furnizim të rregullt me energji, ndriçimin publik, parqet publike dhe varrezat,
- 13.13. Ndërtimin, kujdesin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe objekteve tjera publike me interes për PNJK të Junikut,
- 13.14. Ofron kushte dhe siguron mbrojtje të ambientit, shfrytëzim racional të tokës, hapësirave publike, shfrytëzim dhe menagjim të pronave dhe pasurisë pronë të PNJK, në harmoni me ligjet lokale dhe qendrore,
- 13.15. Rregullon hapësirat për trafikun urban, publik dhe vend parkingjet,
- 13.16. Emërimet dhe rrimërimet e institucioneve komunale, lagjeve, rrugëve, shesheve, dhe vende të tjera publike në nivel lokal të përcaktuara me ligj,
- 13.17. Nxjerr rregullore për aktivitetet lokale të komunës,
- 13.18. Zbaton drejtpërdrejt dispozitat dhe aktet tjera ligjore të Pushtetit Qendror.
- 13.19. Aktivitete tjera të rëndësishme për administrim adekuat të territorit komunal të përcaktuara me ligj,
- 13.20. Cakton kundërvajtje për shkelje të dispozitave (akteve) që i sjell Kuvendi i PNJK dhe organet e tij (sipas rregulloreve),
- 13.21. Ushtron dhe punë tjera në pajtim me dispozitat e veçanta ligjore të miratuara nga pushteti qendror si: regjistrimin e popullsisë, votuesve, regjistrin e kadastrit dhe regjistrimin e bizneseve.

Neni 14.

Ushtrimi administrativ i përgjegjësive dhe pushteteve të PNJK-së konform nenit 4.3 të Urdhërësës Administrative 2005/11 do të filloi gradualisht, në mënyrë progresive dhe proporcionale konform ndërtimit të kapaciteteve lokale.

K a p i t u l l i I I I

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në mbledhje, aktiviteti dhe mënyra e vendosjes në punët publike

Pjesa 2

Neni 15.

Mbledhjet e Kuvendit të PNJK-së janë të hapura me përjashtim të mbledhjeve që Kryetari i Kuvendit apo Kuvendi vlerëson se nuk janë në interes të informimit publik (neni 7.4 të rregullores).

Neni 16.

Qytetarët në PNJK kanë të drejtë të shqyrtojnë dhe propozojnë çështjet me interes përmes konsultimeve dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të tyre në tubime të organizuara nga PNJK.

Neni 17.

PNJK dhe komitetet e saj, para miratimit të vendimeve apo akteve të tjera praktikon mënyrë të gjerë të konsultave paraprake publike, duke ofruar informata të nevojshme publikut të interesuar dhe OJQ-ve përmes formave si:

- 17.1. Fushat informative për publicitet dhe promovim të programeve rreth aktiviteteve komunale,

- 17.2. Kontaktet me qarqe të zgjedhura qofshin ato profesionale apo politike, që mbështesin iniciativat lidhur me projektin (rregulloren, vendimin), apo programin e caktuar,
- 17.3. Transparenca e propozimeve lidhur me praktikën apo projekt-rregulloren, vendimin, urdhrin përmes informimit publik në media (TV, radio, gazeta), duke ftuar për pjesëmarrje dhe dhënien e propozimeve për çështjet e caktuara,
- 17.4. Organizimin e kontakteve dhe konsultave të drejtpërdrejta me grupet përkatëse të interesit, me komitetet këshillëdhënëse, me shoqatat profesionale përmes takimeve të punës, seminareve, debateve, anketa dhe dëshmime publike,
- 17.5. Takime dhe seanca publike,
- 17.6. Shpallje publike të projekteve dhe rregulloreve komunale me interes për qytetaret.

Neni 18.

PNJK së paku dy herë në vit organizon tubime publike me qytetarë, si formë e realizimit të qeverisjes lokale. Në tubimet publike, përfaqësuesit e PNJK-së informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale. Tubimet janë të karakterit të hapur dhe mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit. Në këto tubime mund të merren iniciativa, të jepen propozime, sugjerime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara.

Njëra prej këtyre mbledhjeve do të mbahet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit fiskal, ndërsa tjetra do të mbahet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit fiskal.

Nëse mbahen me tepër se dy takime me publikun gjatë vitit fiskal, atëherë duhet të ketë një interval prej së paku dy muajve apo me se voni 6 muaj para zgjedhjeve lokale. Tubimet e tilla mund të organizohen nëpër fshatra, lagje dhe vendbanime të caktuara.

Neni 19.

Koha, dita dhe vendi ku mbahet tubimi publik shpallet përmes mjeteve të informimit publik, dhe atë dy javë para mbajtjes së mbledhjes. Shpalljen publike e bën PNJK përmes përfaqësuesve të autorizuar. Tubimet publike janë të hapura për përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

Neni 20.

Tubimet publike i udhëheq dhe i kryeson kryetari i Kuvendit të përkohshëm të PNJK.

Ai (ajo) ka autoritetin të caktojë rendin e ditës dhe procedurën për udhëheqje të diskutimeve. Në rast nevoje, ka të drejtë që të ndërpresë diskutimet për çështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat e PNJK. Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, pyetje për të cilën aty për aty nuk mund të epet përgjigje, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigjen me shkrim brenda 30 ditëve pas mbajtjes së mbledhjes.

Neni 21.

Për çdo tubim publik mbahet procesverbali, i cili përmban të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit e PNJK, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimi ndaj tyre, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna. Procesverbalin me të gjitha çështjet e diskutuara dhe propozimet e dhëna e shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa, në afat prej 60 ditëve nga dita e mbajtjes së tubimit. Komiteti analizon çdo propozim të parashtruar në mbledhje dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat ia propozon Kuvendit të përkohshëm të PNJK-së për mbledhjen e ardhshme.

Peticionet

Neni 22.

Qytetarët me të drejtë vote dhe me vendbanim në territorin e komunës, kanë të drejtë që me vetiniciativë qytetare, përmes formës së peticionit dhe projekt propozimeve t'i propozojnë Kuvendit të përkohshëm të PNJK nxjerrjen e akteve me të cilat do të rregullohen çështje të rëndësishme për PNJK. Iniciativa qytetare mund të bëhet për mirëmbajtjen e rendit në PNJK. Iniciativa qytetare fillon me nënshkrimin e qytetarëve, në formë të peticionit, me propozim të veçantë të çështjes së caktuar dhe i adresohet Kuvendit të përkohshëm të PNJK komunal përmes Kryeshefit Ekzekutiv.

Çdo peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e parashtruesit, emrat dhe adresat e nënshkruesve si dhe

lëndën e peticionit.

Neni 23.

Kryeshefi Ekzekutiv, në afat prej 6 (gjashtë) javëve nga dita që ai e pranon çdo peticion të kompletuar ai duhet ti prezantojë Kuvendit të përkohshëm të PNJK-së. Kuvendi i përkohshëm i PNJK-së mund t'ia referojë për shqyrtim të mëtejme Komitetit të caktuar. Në mbledhje të Komitetit, me rastin e shqyrtimit, parashtruesi i peticionit ka të drejtë të pjesëmarrjes në mbledhje.

Vendimin përfundimtar për çështjen e peticionit e merr Kuvendi i përkohshëm i PNJK-së në afatin prej 6 (gjashtë) javëve nga dita e prezantimit të peticionit.

Vendimi do të arsyetohet me shkrim dhe do t'i kumtohet parashtruesit(-sve) të peticionit.

23.1. Ankesat e qytetarëve duhet te procedohen sipas nenit 35 te rreg. 2000/45.

Organizatat jofitimprurëse

Neni 24.

24.1. PNJK përkrahë funksionimin e organizatave jofitimprurëse, duke përfshirë edhe shoqatat e anëtarëve të komuniteteve, nëse organizatat e tilla ofrojnë shërbime në kuadër të përgjegjësisë së përgjithshme të komunës.

24.2. Komuna mund të bëjë marrëveshje me cilëndo organizatë të tillë me qëllim të ofrimit të shërbimeve.

24.3. Të gjitha organizatat e tilla duhet ta respektojnë ligjin në fuqi kur kryejnë aktivitete apo i ofrojnë shërbime komunës.

Kapitulli IV

Organet e Kuvendit të Përkohshëm të PNJK dhe shërbimi civil

Pjesa 1

Neni 25.

PNJK ka organet e veta, të cilat kryejnë funksionet e përcaktuara me këtë Statut apo me Rregulloren përkatëse, si dhe shërbimet komunale që janë në interes të qytetarëve.

Neni 26.

PNJK sipas nevojës, mund të bëjë aranzhmane ndërmjet komunave për mbikëqytjen e përbashkët të ndërmarrjeve komunale që ofrojnë shërbime komunale për më shumë se një komunë.

Neni 27.

Organet PNJK janë: Kuvendi i përkohshëm i PNJK-së, Kryetari i Kuvendit të përkohshëm, Zëvendëskryetari, Komitetet, Kryeshefi Ekzekutiv, Bordi i Drejtorëve.

Kuvendi i përkohshëm i PNJK-së mund të përcaktojë strukturën e Drejtorateve sipas nevojës.

Neni 28.

PNJK ka bashkëpunim dhe bashkëkoordinim të punëve dhe detyrave që i delegohen nga Autoriteti Qendror (MAPL) dhe nuk mund ta cenojë karakterin unik të tij.

Kuvendi i Përkohshëm i PNJK

Neni 29.

Kuvendi i Përkohshëm i PNJK-së është organi më i lartë përfaqësues i pushtetit në PNJK, i cili ushtron funksionin e pushtetit lokal të përcaktuar me këtë Statut. Anëtarët kanë të drejta dhe detyra të barabarta, të përcaktuara me këtë Statut dhe rregullat e procedurave të Kuvendit.

Funksionet e kuvendit të përkohshëm të PNJK-së

Neni 30.

- 30.1. Kuvendi i përkohshëm i PNJK nxjerr Statutin dhe e ndryshon atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Statuti rregullon realizimin e përgjegjësisë të PNJK ashtu siç është rregulluar sipas rregullores 2000/45. Vendimi për nxjerrjen apo ndryshimin e Statutit aprovohet me votimin “për” e dy të tretave (2/3) të anëtarëve të Kuvendit.
- 30.2. Kuvendi i Përkohshëm i miraton Rregullat e Procedurave dhe mund t’i ndryshojë ato nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme. Rregullat e procedurave duhet të sigurojnë udhëheqjen dhe kontrollin, duke përfshirë kontrollin efikas financiar të administratës së PNJK-së. Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Rregullave të Procedurave aprovohet me votimin “për” të më shumë se gjysmës së anëtarëve prezentë që votojnë në mbledhjen, në të cilën propozimi shqyrtohet.
- 30.3. Kuvendi i përkohshëm nuk mund të delegojë kompetencën e vet për marrjen e vendimeve lidhur me:
- 30.4. Aprovimin e buxhetit,
- 30.5. Aprovimin e çështjeve të tjera financiare, që sipas Statutit dhe Rregullave të procedurave i janë lënë Kuvendit të përkohshëm,
- 30.6. Kompensimet për anëtarët e zgjedhur,
- 30.7. Raportin vjetor,
- 30.8. Miratimin, ndryshimin dhe anulimin e akteve lokale,
- 30.9. Krijimin e Komiteteve që përcakton Statuti,
- 30.10. Emërimin e Bordit të Drejtorëve,
- 30.11. Nivelin e pagesave dhe çmimeve,
- 30.12. Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekorimeve dhe titujve të nderit,
- 30.13. Emërtimin dhe riemërtimin e vendbanimeve, rrugëve, vendeve të tjera publike. Vendimi për emërtim apo riemërtim të çfarëdo sheshi, rruge apo vendi tjetër publik, duhet të miratohet së paku nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të përkohshëm.
- 30.14. Bërjen e planeve dhe marrëveshjeve.
- 30.15. Kuvendi i përkohshëm i PNJK mund të delegojë autorizimin lidhur me nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër, një Komiteti të Kuvendit të përkohshëm, Kryetarit apo Kryeshefit Ekzekutiv. Kuvendi i i përkohshëm i PNJK autorizimin e deleguar mund ta revokojë në çdo kohë. Një autorizim i deleguar mund të delegohet edhe më tej brenda autoritetit të caktuar me këtë Statut.
- 30.16. Zgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv
- 30.17. Dhënien e pronave të PNJK në shfrytëzim sipas nevojave dhe ligjeve në fuqi.

Kryesimi i mbledhjeve

Neni 31.

Kuvendi i përkohshëm e zgjedh kryetarin e PNJK-së, i cili/cila i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit të përkohshëm Komunal. Rregullat e procedurave parashohin mënyrën e thirrjeve dhe udhëheqjen e Kuvendit të përkohshëm. Rregullat e procedurave parashohin çështjen e thirrjes dhe udhëheqjes së mbledhjeve nëse vendet e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit janë të lira, ose nëse të dy për çfarëdo arsye, nuk janë në gjendje të marrin pjesë në mbledhje.

Kuorumi dhe mbledhjet

Neni 32.

Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të përkohshëm dhe të komiteteve të tij përbëhet prej më tepër se gjysmës së anëtarëve të Kuvendit të përkohshëm. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të përkohshëm dhe të komiteteve, të gjithë anëtarët, duke përfshirë edhe kryesuesin e mbledhjes, kanë vetëm një votë, por kryesuesi e ka një votë shtesë në rast të numrit të njëjtë të votave “për” ose “kundër” ndonjë propozimi. Kuvendi i përkohshëm dhe komitetet marrin vendime me vota të hapura, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut. Vendimet e Kuvendit të përkohshëm dhe të komiteteve të tij merren me votimin e shumicës së anëtarëve prezent, përveç nëse kërkohet ndryshe me këtë Statut.

Neni 33

Kuvendi i përkohshëm mbledhet sa herë që është e paraparë me Rregullat e procedurave, por së paku duhet të mbajë dhjetë (10) mbledhje brenda vitit fiskal. Mbledhjet e Kuvendit të përkohshëm gjithashtu mund të thirren me kërkesën e një të katërtës (1/4) së të gjithë anëtarëve të zgjedhur ose një nga komitetet e Kuvendit.

Më së paku shtatë ditë pune para çfarëdo mbledhje të Kuvendit të përkohshëm, ose në raste urgjente, tri ditë më herët, delegatët e Kuvendit të përkohshëm duhet të njoftohen me kohën, datën dhe vendin e mbledhjes, si dhe me rendin e ditës. Njoftimet publike duhet po ashtu të shpallen në të njëjtën kohë.

Procesverbali

Neni 34

- 34.1. Për te gjitha takimet e kuvendit dhe komiteteve duhet te mbahet procesverbali i cili duhet ti përmbajë elementet me qenësore (emrat e anëtareve prezent, mysafiret, rendin e punës, esencën e diskutimeve, dhe rezultatin numerik nëse votohet.
- 34.2. Procesverbali duhet ti përmbaj propozimet e miratuara apo te refuzuara,
- 34.3. Për mirëmbajtjen dhe përpilimin e procesverbalit duhet te kujdeset KSHE ose i autorizuari i cili do te pajisë secilin anëtarë me një kopje te tij që do te miratohet ne seancën e radhës.

Kryetari

Neni 35.

Kryetari i PNJK zgjidhet nga Kuvendi i përkohshëm nga përbërja e anëtarëve të tij. Mandati i atij/asaj është i njëjtë me mandatin e Kuvendit të përkohshëm.

Kryetari nuk mund të zgjidhet më tepër se dy mandate.

Neni 36.

Kryetari i Kuvendit të përkohshëm thërret mbledhjet e Kuvendit të përkohshëm dhe i kryeson ato, organizon punën e Kuvendit të përkohshëm, dhe harmonizon punën e komiteteve.

Neni 37.

Kryetari i Kuvendit të përkohshëm ka të drejtë dhe detyrë që:

- 37.1. Ta përfaqësojë PNJK brenda dhe jashtë saj.
- 37.2. Të propozojë buxhetin dhe raportin vjetor buxhetor, programet zhvillimore, planet urbanistike dhe plane e programe tjera
- 37.3. Të propozojë vendimet, dispozitat e tjera dhe aktet e përgjithshme të cilat i miraton Kuvendi i përkohshëm,
- 37.4. Të kujdeset për zbatimin e dispozitave të Rregullores për vetëqeverisje komunale dhe dispozitave të tjera ligjore të Pushtetit Qendror,
- 37.8. Pas konsultimeve me partitë politike të propozojë Kryeshefin Ekzekutiv dhe anëtarët e Bordit administrativ komunal,
- 37.9. Të mbikëqyrë administrimin e përgjithshëm financiar të PNJK dhe zbatimin e vendimeve të marra nga Kuvendi i përkohshëm,
- 37.10. Organizon mënyrën e punës së administratës vendore,
- 37.11. Të japë pëlqimin në aktet mbi organizimin e brendshëm të PNJK,
- 37.12. Të kujdeset për realizimin e publicitetit të punës së Kuvendit të përkohshëm me anëtarët e Pushtetit Qendror dhe Komunat tjera,
- 37.13. Të mbikëqyrë zbatimin e Rregullave të procedurave dhe të Statutit.

Zëvendëskryetari

Neni 38.

Kuvendi i përkohshëm zgjedh zëvendëskryetarin nga përbërja e anëtarëve të tij. Ai/ajo i ndihmon kryetarit në kryerjen e funksioneve të tij. Zgjedhja e zv. kryetarit-ve në pajtim me nenin përkatës të Statutit, është e njëjtë me procedurën e zgjedhjes së kryetarit.

Për punën e tij, zv. kryetari i përgjigjet kryetarit, e në rastin kur, në mungesë të kryetarit ai e kryen detyrën e tij, atëherë ai i përgjigjet Kuvendit të përkohshëm.

Zëvendëskryetari shtese

Neni 39.

Emërimi i zv/kryetarit shtesë nga komitetet pakicë bazohet në nenin 25.3 të Rregullores 2000/45.

Drejtori Ekzekutiv

Neni 40.

Kuvendi i përkohshëm me propozimin e Kryetarit të PNJK-së me shumicë votash e emëron Drejtorin Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv nuk është anëtar i Kuvendit të përkohshëm, por për punën e tij/saj i përgjigjet Kuvendit të përkohshëm.

Neni 41.

Drejtori Ekzekutiv kryen këto punë:

- 41.1. Kryeson Bordin e drejtorëve – shefave të sektorëve,
- 41.2. Kujdeset për ligjshmërinë e punës së organeve administrative,
- 41.3. Kujdeset për ligjshmërinë e çështjeve financiare të PNJK, zbatimin e procedurave dhe të kontrollit të efektiveve financiare, në përputhje me kërkesat e Pushtetit Qendror,
- 41.4. Është përgjegjës për interpretimin e dispozitave që dalin nga Rregulloret, Statuti, Rregullat e procedurave para Kuvendit të përkohshëm, Kryetarit, Komiteteve dhe Bordit të drejtorëve,
- 41.5. Udhëheq me personelin e Shërbimit civil dhe është përgjegjës për kushtet e emërimit dhe shkarkimit – largimit të personelit në shërbimin civil pranë PNJK,
- 41.6. Përgatit propozimin e vendimeve dhe akteve tjera që i propozohen Kuvendit të përkohshëm për miratim,
- 41.7. Kujdeset për organizimin dhe mirëvajtjen e seancave të Kuvendit të përkohshëm, të Komiteteve, të Bordit të drejtorëve dhe të trupave publike,
- 41.8. Kryen edhe të gjitha punët tjera që i caktohen me Rregullat e procedurave me këtë Statut ose që i ngarkohen nga kryetari dhe Kuvendi i përkohshëm.

Shkarkimi nga detyra dhe vendi i punës

Neni 42.

- 42.1. Kryetari dhe zv/kryetari i PNJK-së mund të shkarkohen nga detyra vetëm me votat e më tepër se dy të tretat (2/3) të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të përkohshëm, vetëm në rast se nuk janë përmbushur autorizimet dhe obligimet sipas këtij Statuti.
- 42.2. Drejtori Ekzekutiv mund të shkarkohet vetëm nga Kuvendi i përkohshëm, për arsye të moskryerjes si duhet të obligimeve të tij / saj ose në interes të efikasitetit. Procedura e shkarkimit të Kryeshefit Ekzekutiv është e njëjtë me procedurën e emërimit – zgjedhjes.
- 42.3. Drejtorin mund ta shkarkojë vetëm Kuvendi i përkohshëm, për arsye të moskryerjes si duhet të obligimeve të tij ose të saj, dhe atëherë kur shuhet Drejtorati përkatës.

Komitetet

Pjesa 2

Neni 43.

Me vendimin të Kuvendit të përkohshëm në PNJK themelohen Komitete të obliguara dhe ato:

1. Komitetin për Politikë dhe Financa,
2. Komitetin për Komunitete dhe
3. Komitetin për Ndërmjetësim.

Përveç komiteteve obliguese, Kuvendi përkohshëm sipas nevojës, mund të formojë edhe komitete të tjera për fusha të caktuara. Përbërja e Komiteteve duhet të pasqyrojë proporcionin e partisimit të partive dhe koalicioneve politike në Kuvendin e përkohshëm. PNJK duhet të beje përpjekje të sigurojë baraspeshë gjinore në të gjitha komitetet. (neni 21.3 i Rreg. 2000/45).

Komiteti për Politikë dhe Financa

Neni 44.

Komiteti për Politikë dhe Financa themelohet nga Kuvendi i përkohshëm. Përbërja e tij mund të jetë nga anëtarët, nga përbërja e Kuvendit të përkohshëm dhe anëtarët, të cilët janë jashtë Kuvendit të përkohshëm. Në mbledhjet e Kuvendit për Politikë dhe Financa mund të marrin pjesë edhe kryetarët e Komiteteve tjera të Kuvendit të përkohshëm OJQ-të dhe media.

Komitetin për Politikë dhe Financa e kryeson Kryetari i PNJK, i cili vendos edhe për çështjet të cilat duhet të shqyrtohen në këtë Komitet. Komiteti për Politikë dhe Financa ka përgjegjësinë:

- 44.1. Për propozimin e projekt-buxhetit,
- 44.2. Për identifikimin dhe hartimin e programeve zhvillimore dhe strategjike të PNJK,
- 44.3. Për përcaktimin e formave dhe mënyrave të organizimit për të hyrat në buxhetin fiskal, si dhe
- 44.4. Bën politikën e investimeve dhe harxhimeve nga mjetet buxhetore.

Komiteti i Komuniteteve

Neni 45.

Komiteti i Komuniteteve themelohet nga Kuvendi i përkohshëm, ndërsa në përbërjen e tij veç anëtarëve të Kuvendit të përkohshëm mund të përfshihen edhe përfaqësues të komuniteteve, të cilët nuk përfaqësohen në Kuvend të përkohshëm, por janë banorë të PNJK. Komiteti, i cili është shumicë në PNJK përfaqësohet me më pak se gjysmën e numrit të anëtarëve të Komitetit, kurse pjesa tjetër e anëtarëve duhet të pasqyrojnë përafërsisht proporcionin (përpjesën) e komuniteteve të tjera që jetojnë në PNJK.

Komiteti për komunitete ka për detyrë të përkrahë dhe mbrojë interesat e komuniteteve që jetojnë në PNJK, dhe çdo shkelje në këtë drejtim e shqyrton veç e veç dhe propozimet e masave i drejton Komitetit për Ndërmjetësim, i cili, pas shqyrtimit, vlerëson se çështja duhet apo jo t'i rekomandohet për shqyrtim Kuvendit.

Neni 46.

Komiteti për Komunitete ka për detyrë që, në kuadër të PNJK, të sigurojë :

- 46.1. Asnjë person i cili merr detyra publike ose mban post publik nuk guxon të bëjë diskriminim ndaj asnjë personi për shkak të përkatësisë etnike, fetare, gjuhës ose raportit me komunitetet,
- 46.2. Të gjithë qytetarët të gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësi të barabartë për punësim në shërbimet komunale në të gjitha nivelet,
- 46.3. Që shërbimi komunal civil të pasqyrojë në proporcion të drejtë numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

Komiteti për ndërmjetësim

Neni 47.

Komiteti për Ndërmjetësim themelohet nga Kuvendi i përkohshëm me numër të barabartë të anëtarëve të Kuvendit të përkohshëm të cilët nuk i përkasin Komitetit të komuniteteve dhe anëtarëve përfaqësues të komuniteteve të PNJK, të cilët nuk i përkasin komunitetit që është shumicë në PNJK.

Neni 48.

Komiteti për ndërmjetësim ka për detyrë:

- 48.1. Të shqyrtojë të gjitha çështjet të cilat ia parashtron Komiteti i komuniteteve,
- 48.2. Të grumbullojë informata, për të konstatuar se janë shkelur ose se a mund të shkelen të drejtat e një komuniteti me ndonjë veprim, të pushtetit lokal.
- 48.3. Të vlerësojë për rekomandim, që çështjen e ngritur dhe të shqyrtuar paraprakisht në Komitet t'ia paraqet Kuvendit të përkohshëm për shqyrtim.

Neni 49.

Komiteti për ndërmjetësim ka për obligim që së pari të angazhohet që çështja e ngritur nga Komiteti i komuniteteve, pas analizave të hollësishme të përpiqet që rastin në fjalë të zgjidhet përmes ndërmjetësimit. Çështjet që arrin t'i zgjidhë përmes ndërmjetësimit nuk ka obligim që t'i rekomandojë Kuvendit për shqyrtim.

Zyra e komuniteteve

Neni 50.

Formimi i zyrës së komuniteteve do të rregullohet sipas nenit 23 të Rregullores 2000/45.

Bordi i Shefave të sektorëve

Pjesa 3

Neni 51.

Kuvendi i përkohshëm me propozim të Kryetarit të PNJK emëron Bordin e shefave të sektorëve. Bordin e shefave të sektorëve e përbëjnë Shefat e sektorëve të PNJK dhe Shefi i Zyrës së Komunitetit .Shefat e Sektorëve për punën e vet i përgjigjen Kuvendit të përkohshëm dhe Kryeshefit Ekzekutiv. Bordi i shefave të sektorëve, bie edhe vendime të tjera administrative në kuadër të kompetencave të veta dhe në bazë të Statutit të PNJK.

Neni 52.

Me rekomandimin e Shefave të sektorëve, Komiteteve dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Udhëzimi Administrativ 2006/02). Kuvendi i Përkohshëm mund të rrisë numrin e sektorëve ose të zvogëlojë ato në pajtim me ligjet e aplikueshme.

Për vitin fiskal 2006 PNJK-ja Junik do të ketë sektorët dhe shefat e sektorëve si vijon:

1. Sektorin për administratë të përgjithshme dhe punë të Përbashkëta.
2. Sektorin për Ekonomi, Buxhet dhe Financa.
3. Sektorin për Arsim dhe Shëndetësi (Koordinator të dy sektorëve)
4. Sektorin për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër

Sektorët punën e tyre mund ta organizojnë nëpërmjet zyrtarëve, varësisht nga vëllimi i punëve.

Neni 53.

Shefat e sektorëve:

- 53.1. Ndihmojnë Kuvendin e përkohshëm dhe Komitetet e tij në sigurimin e të gjitha informacioneve dhe raporteve për procesin e marrjes së vendimeve.
- 53.2. Ndihmojnë Kryetarin dhe Drejtorin Ekzekutiv në mirëvajtjen e punëve të përditshme dhe që kanë të bëjnë me drejtorinë përkatëse;
- 53.3. Zbatojnë të gjitha aktet dhe vendimet e PNJK,
- 53.4. Përgatisin programin e punës dhe prezantojnë raportet periodike të punës për sektorin përkatës,
- 53.5. Propozojnë personelin udhëheqës dhe personelin tjetër-kryes të detyrave të punës për drejtorinë e vet,
- 53.6. Kryejnë edhe punë të tjera me të cilat i ngarkon Kuvendi i përkohshëm, Kryetari ose dispozitat e veçanta ligjore të Autoritetit Qendror.
- 53.7. Janë përgjegjës për udhëheqjen dhe kontrollin e përditshëm të punës së sektorëve të tyre dhe stafin që punon në to.
- 53.8. Propozojnë projekt rregullorë komunale.

Neni 54.

Zyrtarët e lartë komunalë: Drejtori Ekzekutiv, anëtarët e Bordit të Shefave të sektorëve, Shefi i Zyrës së komunitetit, Shefi i sektorit, nuk mund të jenë anëtarë të Kuvendit të përkohshëm ku ata janë të punësuar.

Neni 55.

Konfliktet e kompetencave ndërmjet zyrtarëve të lartë të PNJK, të cilët janë emëruar nga Kuvendi i përkohshëm i zgjedh Kuvendi i përkohshëm.

Zyrtarët e lartë mund të largohen nga posti me dorëheqje ose mund të shkarkohen nga Kuvendi i përkohshëm, vetëm në rast se nuk i kryejnë si duhet obligimet apo kur pushon nevojja për atë post.

Shërbimi Civil Komunal

Pjesa 4

Neni 56.

Me qëllim të organizimit të shërbimeve, të kryerjes së punëve dhe përmbushjes së nevojave të drejtpërdrejta të banorëve, në kuadër të PNJK organizohet Shërbimi Civil i PNJK. Shërbimin Civil të PNJK e përbëjnë: Drejtori Ekzekutiv, Bordi i Shefave të sektorëve dhe personeli administrativ. Shërbimi Civil PNJK i kryen detyrat dhe obligimet në mënyrë korrekte dhe të paanshme, duke vepruar në pajtim me ligjin. Personeli i shërbimit civil angazhohet në punë përmes konkursit publik, dhe zgjedhja bëhet në bazë të meritës, vlerës dhe aftësisë profesionale. Të gjithë nëpunësit civilë të PNJK i zbatojnë urdhrat e eprorëve të tyre dhe i përfillin urdhrat e tyre, përveç në ato raste kur urdhrat detyrat e tyre janë në kundërshtim me ligjin ose me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Shërbimi civil i PNJK duhet të pasqyrojë në mënyrë profesionale numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

- 56.1. Emërimet e personelit bëhen sipas rregullores 2001/36 ku parashihen kushtet, kualifikimet, paneli, ankesat, dhe përgjigjet ne ankesat e caktuara.

Kapitulli V

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit

Pjesa 1

Neni 57.

Në kuadër të drejtave dhe detyrave të Kuvendit të përkohshëm, secili anëtar ka të drejtë të nisë iniciativa dhe të bëjë propozime, që Kryetari, Drejtori Ekzekutiv, Komiteteve, Shefave të sektorëve, t'u bëjë pyetje dhe të kërkojë informacion dhe sqarime, e që nga organet e qeverisjes lokale dhe shërbimet profesionale të kërkojë ndihmë profesionale dhe sqarime të duhura për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Kuvendit të përkohshëm.

Neni 58.

Anëtari nuk mund të thirret në përgjegjësi penale e as të arrestohet, të paraburgoset ose të dënohet për

mendimin e shprehur dhe votën në Kuvend të përkohshëm.

Çdo anëtar i Kuvendit të përkohshëm ka të drejtë në mbledhje të Kuvendit të përkohshëm t'i parashtrijë pyetje Kryetarit të PNJK, Kryeshefit Ekzekutiv dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, për çështjet nga fushëveprimi në PNJK.

Neni 59.

Çdo anëtar i Kuvendit të përkohshëm ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për shqyrtim të çështjeve të caktuara në lidhje me punën e Kryetarit dhe udhëheqësve të tjerë të PNJK, të emëruar nga Kuvendi i përkohshëm. Kërkesa me shkrim i paraqitet Kuvendit të përkohshëm të PNJK, me pyetjet të cilat duhet të shqyrtohen dhe duhet të jenë të formuluar qartë dhe arsyeshëm.

Neni 60.

Anëtarëve të Kuvendit të përkohshëm iu jepet librezë – karta e identifikimit të anëtarit. Përmbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës së librezës së anëtarëve e përcakton Kuvendi i përkohshëm, ndërsa për procedurën e lëshimit kujdeset D.Ekzekutiv.

Neni 61.

Anëtari i Kuvendit të përkohshëm për pjesëmarrje në seancat e Kuvendit të përkohshëm dhe në mbledhjet e Komiteteve lirohet nga obligimet e punës në ndërmarrjen – institucionin ku ka marrëdhënie të rregullt pune, dhe se për këtë mungesë nga puna nuk mund t'i zvogëlohen të ardhurat nga paga. Anëtari ka të drejtë në kompensim për punën dhe aktivitetin e tij si anëtar i Kuvendit të përkohshëm . Kompensimi për anëtarët e Kuvendit të përkohshëm caktohet me vendim të posaçëm nga Kuvendi i përkohshëm, i cili ndahet nga buxheti i PNJK.

61.1. Anëtarët e Kuvendit të përkohshëm, Komitetit dhe kryetarët kompensohen për punën e tyre, lartësia e kompensimit caktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit, në pajtim me vendimet e lëshuara nga Pushteti Qendror.

Kapitulli VI

Administrimi financiar

Pjesa 1

Neni 62.

Buxheti i PNJK duhet të jetë i balancuar, transparent dhe i bazuar në kritere objektive. Buxheti duhet të përmbajë planin për aktivitetet ekonomike brenda vitit fiskal, burimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe ato të përditshme të PNJK. Mënyra e konsolidimit të buxhetit dhe shpenzimet e mjeteve definojnë me këtë Statut, rregulloret dhe aktet e tjera të aprovuara nga Autoriteti Qendror.

Neni 63.

Për buxhetin e PNJK të hyrat sigurohen nga:

1. Autoriteti Qendror
2. Të hyrat vetanake të PNJK
3. Donatorët ndërkombëtarë
4. Nga vetë kontributi i qytetarëve.

Të hyrat nga Autoriteti Qendror Fiskal

Neni 64.

PNJK-së, një pjesë e mjeteve i ndahet nga Autoriteti Qendror sipas kriterëve të parapara për ndarjen e mjeteve PNJK. PNJK është e obliguar që me kohë t'i drejtohet Autoritetit Qendror, me kërkesë të arsyetuar për mjetet që duhet t'i ndahen. Nëse nga Autoriteti Qendror i ndahen PNJK mjete me destinim për një veprimtari të caktuar, ato mjete nuk mund të harxhohen për qëllime tjera.

PNJK duhet të njoftohet me kohë mbi lartësinë e mjeteve që i ndahen nga Autoriteti Qendror. PNJK duhet t'i raportojë Autoritetit Qendror për mënyrën e harxhimit të mjeteve që i ndahen nga Autoriteti Qendror.

Të hyrat vetanake të PNJK

Neni 65.

PNJK mund të krijojë të hyra vetanake në përputhje me ligjet dhe udhëzimet e Pushtetit Qendror nga:

1. Licencat dhe Pagesat që i cakton PNJK,
2. Të ardhurat nga pasuria e PNJK,
3. Gjobat dhe përçindja e gjobave,
4. Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës së PNJK.

Të hyrat nga donatorët

Neni 66.

Për ta ndihmuar zhvillimin e PNJK, donatorët ndërkombëtarë mund të derdhin mjete në Buxhetin e PNJK. Nëse donatorët derdhin mjete në Buxhetin e PNJK me destinim të caktuar, ato mjete nuk mund të përdoren për qëllime të tjera. Donatorët kanë të drejtë të informohen për mënyrën e harxhimit të mjeteve që i kanë derdhur në Buxhetin e PNJK.

Të hyrat nga vetë kontributi

Neni 67.

Për t'i përmbushur më mirë apo përmirësuar nevojat e qytetarëve, PNJK mund të sigurojë mjete edhe përmes donacioneve vullnetare të qytetarëve në pajtim me Ligjin. Mjetet e siguruar në këtë mënyrë mund të shfrytëzohen vetëm për atë për çka janë deklaruar qytetarët. Mënyra e deklarimit dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me vetëkontributin, më afër definohen me ligj dhe me vendim për vënien e vetkontributit.

Neni 68.

PNJK menagjon në mënyrë të pavarur me të hyrat që i takojnë. Për mënyrën e përdorimit të mjeteve vendos Kuvendi i përkohshëm sipas propozimit të Komitetit për Politikë dhe Financa. Marrja hua dhe dhënia e mjeteve nga PNJK do të rregullohet me ligjet e aplikueshme

Neni 69.

Buxheti i PNJK aprovohet për një vit fiskal. Viti fiskal fillon me 1 janar. Komiteti për Politikë dhe Financa është i obliguar që me kohë t'ia prezantojë Kuvendit të përkohshëm Projektin e Buxhetit për miratim. Me Buxhetin e PNJK duhet të parashihen të hyrat dhe të dalat për vitin fiskal, mënyra e shpenzimit të tyre dhe veprimtaritë për çka destinohen.

Neni 70.

Në fund të çdo viti fiskal duhet të publikohet raporti vjetor për Buxhetin. Raportin vjetor e aprovon Kuvendi i përkohshëm në bazë të propozimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, më së largu deri me 30 Maj të vitit vijues. Raporti duhet të përmbajë:

- 70.1. Të hyrat dhe të dalat e planifikuara,
- 70.2. Realizimet, synimet e planifikuara me buxhet dhe shkallët e realizimit të tyre,
- 70.3. Mënyrën dhe lartësinë e financimit të aktivitetit të caktuar,
- 70.4. Gjendjen financiare të PNJK në fund të vitit fiskal,
- 70.5. Raporti për kontrollin financiar,
- 70.6. Gjendjen financiare në ndërmarrjet e PNJK, buxhetin e të cilave e miraton dhe kontrollon Kuvendi i përkohshëm, dhe
- 70.7. Të dhënat tjera të parapara me Ligj dhe akte tjera nga lëmi i financave.

Neni 71.

PNJK miraton Buxhetin e ndërmarrjeve komunale që kryejnë shërbime publike. Buxheti i propozuar nga ndërmarrjet komunale duhet të përfshijë lartësinë e tarifës së propozuar për shërbimet që kryen ndërmarrja dhe të dhënat tjera të parapara me ligj. Propozimi i buxhetit duhet t'i dorëzohet Kuvendit të përkohshëm për miratim më së largu deri me 1 dhjetor, para vitit të ardhshëm fiskal.

Nëse një ndërmarrje ka kryer shërbime publike për më shumë komuna, për të cilat ndërmarrja kryen shërbime, me marrëveshje definojnë mënyrën e mbikëqyrjes të veprimtarisë së asaj ndërmarrje. PNJK kontrollon dhe mbikëqyr afarizmin financiar të ndërmarrjeve publike komunale dhe të gjitha organizatat jofitimprurëse, e të cilat marrin ndihmë financiare nga PNJK.

Neni 72.

Pushteti Qendror cakton revizorë të pavarur financiarë me qëllim të kontrollimit të aktiviteteve financiare në PNJK. Revizori ka të drejtë t'i shikojë të gjitha deklaratat financiare, librat, shkresat dhe dokumentet tjera dhe mund t'i kërkojë të gjitha të dhënat, të cilat atij ose asaj i duhen për kryerjen e kontrollit. Revizori e kontrollon gjithë afarizmin – veprimtarinë financiare të ndërmarrjeve komunale, në prezencë dhe bashkëveprim me kontrolluesit e PNJK-së. Revizori inspekton tërë veprimtarinë financiare të të gjitha organizatave jofitimprurëse, të cilat marrin ndihmë financiare nga PNJK së bashku me kontrolluesit e PNJK-së.

Çdokush mund të paraqesë deklaramë të revizori lidhur me veprimtarinë financiare dhe çështjet tjera financiare të PNJK-ës. Revizori mund të vendosë që t'i hetojë ato deklaramë. Revizori i dorëzon Kuvendit të përkohshëm raport me shkrim për çdo kontroll financiar, për të cilin Kuvendi i përkohshëm merr vendim për veprimet që duhet të ndërmerren lidhur me secilin rekomandim që përmban raportin.

Kuvendi i përkohshëm nuk mund ta refuzojë asnjë prej rekomandimeve pa arsye të mjaftueshme dhe arsyet duhet të shënohen në procesverbalin e mbledhjes përkatëse.

Kapitulli VII

Konflikti i interesave

Neni 73.

Delegatët e Kuvendit të përkohshëm, Komiteti, Bordi i Drejtorëve, Kryetari, Zv. kryetari, Kryeshefi Ekzekutiv, përjashtohen nga procedurat lidhur me marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij ose asaj, ka interes personal apo material. Përjashtim nga procedurat e marrjes së vendimeve dhe procedurat administrative të personave të përmendur mund të bëhet me tërheqjen e tyre vullnetare ose në të kundërtën me vendim të shumicës së atij forumi ose me kërkesë të palës së tretë nëse i përmenduri është drejtpërdrejtë i përfshirë në atë çështje e cila mund të shpie deri te konflikti i interesave.

Neni 74.

Çdo anëtar i Kuvendit të përkohshëm dhe zyrtar i lartë i PNJK obligohet që të bëjë deklaratë paraprake me shënime të plota mbi interesat e tyre financiare në momentin e pranimit në funksion, sikur edhe për çdo ndryshim eventual që ndodh gjatë mandatit. Për regjistrat në fjalë kujdeset Kryeshefi Ekzekutiv, ndërsa për zyrtarët e lartë të PNJK, Kryetari i PNJK.

Kapitulli VIII

Dispozitat e veçanta

Neni 75.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas mënyrës dhe procedurës së njëjtë me të cilën është nxjerrë ky Statut.

Neni 76

Ky statut do te shfuqizoj te gjitha dispozitat dhe aktet e aplikueshme statutore te mëparshme. Ne rast te çështjeve te pa rregulluara qarte me këtë statut ose ne rast konflikti ose dykuptimësie, do te zbatohet ligji si dhe vendimet dhe dispozitat e pushtetit qendror.

Neni 77.

Prej ditës së miratimit të këtij Statuti në afatin më të shkurtër të bëhet harmonizimi i të gjitha akteve dhe rregulloreve me këtë Statut.

Neni 78.

Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i përkohshëm i PNJK.

KUVENDI PËRKOHSHËM I PILOT NJËSISË KOMUNALE JUNIK

18.04.2006

Kryetari:

Junik

z.Tahir Isufaj